


**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Tetor, 2022**

Anëtarësimi në sindikata duhet lënë ashtu si ishte

Ideja e Kosova e ngutshme dhe e shoqëruar me plot defekte



Pa dashur të bëjmë vlerësime se cili është qëllimi që Ministria gjegjëse përmes Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit lëshoi një mesazh dhe kërkoi që anëtarët e sindikatave të regjistrohen rishtazi në eKosova, në praktikë po tregohet se vegëza për regjistrim e deklarim të anëtarësisë ishte veprim i ngutshëm dhe shoqërohet me plot defekte. Duke analizuar funksionimin dhe mos funksionimin e kësaj vegëze SBASHK ka ... (faqe 4)

Detyrë konkrete nga takimi konsultativ me kryetarët

Vizita nëpër shoqata sindikale për bashkëbisedë me anëtarësinë

Në takimin nga larg të 26 tetorit me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve është bashkëbiseduar ... (Faqe 6)

Veprimtarët e devotshëm sindikal nuk e harrojnë sindikatën e tyre


Sadik Shala - ndjehem krenar me SBASHK-un



Sadik Shala është nga veprimtarët e ... (faqe 3)

Takime të përditshme konsultative me udhëheqës të SBASHK-ut

Angazhime konkrete për t'u përballur suksesshëm me sfidat e kohës



Në SBASHK vazhdojnë të mbahen ... (faqe 4)

Vendimi i njëanshëm i Ministres Nagavci

Kur vendoset me inat, puna nuk ka rrjedhë të mbarë



Në vend që t'i lente inatet me një ... (faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Qeveria dhe sindikatat



Kudo në shtetet e botës njëri nga matësit e demokracisë së atij vendi është qasja e Qeverisë ndaj sindikatave dhe kërkesave të tyre. Për të pasur sa më pak përplasje janë nxjerr edhe Ligje dhe janë formuar organe për dialogun social. Në Kosovë me qëllim të nxitjes së dialogut dhe arritjes së marrëveshjeve është formuar Këshilli Ekonomik Social duke i dhënë hapësirë Qeverisë, Odave dhe Sindikatave të përfaqësohen me nga 5 anëtarë, që në shikim të parë kanë të drejta të barabarta për të debatuar e për të përfaqësuar zërin e anëtarësisë së tyre. Ky organ, po funksionoi si duhet, mundëson debat dhe propozime konkrete, të cilat pastaj mund të kthehen lehtë e në pajtueshmëri të palëve në marrëveshje dhe kështu hiqen arsyet për përplasje e veprime sindikale.

Në këtë Këshillin Ekonomik Social të Kosovës ka kohë që mungon dialogu social dhe kjo edhe ka sjellë deri te shumë përplasje e madje edhe veprime sindikale. Të njëjtën qasje që

kanë 5 përfaqësuesit e Qeverisë e ka edhe vetë Qeveria. Kjo qasje është e gabuar dhe jep përshtypje sikur Qeveria nuk do që të ketë sindikata të organizuara mirë e me vizion të qartë. Kjo u dëshmuar edhe gjatë grevës së nisur në gusht. Kjo u pa edhe pas pezullimit të grevës. Qeveria me kërcënime u mundua t'i frikësojë sindikalistët madje edhe duke u thënë se nuk do ua jep pagën një pjese të tyre për arsye të grevës edhe pse në të njëjtën kohë pjesës tjetër që ishin në grevë ua ndau me kohë pagën e shtatorit. Më shumë se kjo duke shkel Ligjin për organizimin sindikal një Ministri “zbuloi” eKosovën me qëllim që të komplikojë organizimin dhe funksionimin e sindikatave. Të punësuarit në arsim, por edhe në sektor të tjerë ishin anëtarësuar ashtu si e kërkonte ligji dhe madje bazuar në një Udhëzim të ri të Ministrisë sindikatat ishin reregjistruar duke e dëshmuar numrin e anëtarësisë përmes listave të deklarimeve, Ministria me nguti e për t'i zënë ngushtë nxori urdhër për t'u regjistruar në eKosova. Anëtarësia e SBASHK-ut po i përgjigjen edhe kësaj sfide dhe vazhdojnë paraqitjet (deklarimet) në eKosova, kurse Qeveria vazhdon me qasje të gabueshme ndaj sindikatave. Ata duhet ta kuptojnë se liria sindikale është liri themelore e individit. Qeveria duhet të jep shembuj se është për demokraci.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Veprimtarët e devotshëm sindikal nuk e harrojnë sindikatën e tyre

Sadik Shala - ndjehem krenar me SBASHK-un



Sadik Shala është nga veprimtarët e devotshëm sindikal. Ai me vite ishte shembull i shkëlqyer i angazhimit dhe me punë e përkushtim krijoi respekt meritë, jo vetëm te punëtorët e arsimit në Suharekë, por edhe te kolegët e tij sindikalistë në tërë Kosovën. Kur Sadiku

mungonte rastësisht në ndonjë aktivitet kolegët e ndjenin këtë mungesë sepse Sadiku me humorin e lehtë krijonte atmosferë përkushtimi e pune dhe e largonte lodhjen. Tani ai është në pension, por SBASHK-un nuk e harron. Viziton stafin qendror dhe u jep kurajë e vullnet për t'u përballur me sfidat.

Arsimimi sot:

Cilat janë momentet që do të veçonit nga aktiviteti juaj në SBASHK?

Sadiku:

Unë edhe sot e gjithmonë ndjehem anëtar i SBASHK-ut. Shumë vite kalova si veprimtar sindikal dhe jam munduar me gjithë mundësitë të jap kontribut për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Ka shumë momente të veçanta nëpër vite e dekada. Kishte edhe shumë sfida e momente kur thoshin se a do ia dalim. Por, me punë e përkushtim e falë unitetit të anëtarësisë dhe punës së madhe të stafit qendror dhe kolegëve të mi nëpër komuna e Universitete kemi shënuar shumë arritje. SBASHK-u ishte, është dhe do të mbetet sindikatë e organizuar mirë dhe zë i fuqishëm i anëtarësisë.

Arsimimi sot:

Kolegët dhe gjithë stafi qendror të respektojnë shumë dhe gëzohen kur i viziton

Sadiku:

Po është e vërtetë dhe unë ndjehem mirë e krenar kur shoh dhe ndjej gjithë atë respekt. Vij me dëshirë t'i vizitoj këta në stafin qendror sepse vërtetë janë shembull i shkëlqyer i përkushtimit dhe angazhimit. Me kryetarin

bashkëbisedojmë për ngjarjet e shumta në të kaluarën dhe vazhdimisht i jap kurajë e vullnet për të vazhduar me angazhimet. Më vjen mirë që kolegët mezi pritnin që të jem edhe unë në aktivitete sepse i dëgjoja duke thënë se ja edhe Sadiku është me ne dhe do të kalojmë mirë e në pauza nuk do të mungoj as humori. Në SBASHK kemi qenë më shumë se kolegë sindikalistë. Kemi qenë dhe jemi si një familje e mirë dhe e madhe.

Arsimimi sot:

SBASHK-u nëpër vite ka kaluar nëpër shumë sfida, por janë shënuar edhe arritje të shumta

Sadiku:

Po ashtu është dhe unë ndjehem krenar duke konsideruar se kam dhënë kontribut, qoftë edhe modest ai, por madhështia është se çdo herë kemi vendosur bashkërisht dhe në mënyrë unanime. Jemi ndalur e kemi biseduar qetë dhe kemi vendosur gjithmonë bashkërisht. Ka arritje të mëdha, por unë do të veçoja Ligjin për punëtorët e arsimit shqip të viteve të 90-ta. Këtë po e them, jo pse edhe unë jam në pension, por pse ky Ligj, që nuk u arrit të bëhej edhe lehtë është ai që njeh vitet 90-ta dhe angazhimin sublim të pishtarëve të dijes në gjithë ato vite duke mbrojtur dritën kundër errësirës. Ky ligj shpreh respekt për ata pishtarë të dijes dhe në shenjë të këtij respekti ata marrin një shtesë në pension, që duket modeste, por ka domethënie të madhe për të gjithë ne ishim në misionin e shenjtë të arsimimit e edukimit të brezave.

Arsimimi sot:

Cila është porosia juaj për punëtorët e arsimit e të kulturës në Kosovë?


Sadiku:

Të vazhdojnë me angazhimin e përkushtimin në misionin e tyre për edukimin e arsimimin e brezave. Anëtarët e SBASHK-ut nga sektori i kulturës të vazhdojnë të kultivojnë vlera të mirëfillta dhe t'i prezantojnë ato para publikut kudo në Kosovë e në tërë botën. Porosia ime është që të vazhdojnë të jenë unik në SBASHK sepse kohët do të sjellin vazhdimisht sfida, por ato kalohen më lehtë kur ka unitet. SBASHK-u ishte dhe do të mbetet zë i fuqishëm i anëtarësisë.

Gjatë muajit

Anëtarësimi në sindikata duhet lënë ashtu si ishte

Ideja e Kosova e ngutshme dhe e shoqëruar me plot defekte




Pa dashur të bëjmë vlerësime se cili është qëllimi që Ministria gjegjëse përmes Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit lëshoi një mesazh dhe kërkoi që anëtarët e sindikatave të regjistrohen rishtazi në eKosova, në praktikë po tregohet se vegëza për regjistrim e deklarim të anëtarësisë ishte veprim i ngutshëm dhe shoqërohet me plot defekte.

Duke analizuar funksionimin dhe mos funksionimin e kësaj vegëze SBASHK ka parë shumë defekte e lëshime nga të cilat po përmendim vetëm disa:

Kemi vërejtur se një person mund të deklarohet disa herë se është anëtar i një sindikate. Kjo platformë nuk ishte dashur të lejojë personin të deklarohet më shumë se një herë.

Takime të përditshme konsultative me udhëheqës të SBASHK-ut

Angazhime konkrete për t'u përballur suksesshëm me sfidat e kohës



Në SBASHK vazhdojnë të mbahen takimet e përditshme nga larg me kryetarët e Kuvendeve të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar dhe të Universiteteve. Këto takime janë konsultative dhe

Lëshim tjetër në këtë vegëz është se si anëtar i një sindikate të caktuar mund të deklarohet çdo qytetar i Kosovës edhe pa qenë fare i punësuar, apo që nuk i takon sektorit që përfaqëson sindikata gjegjëse. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për organizimin sindikal dhe me Statutin e sindikatës gjegjëse.

Po ashtu vegëza si është tani i mundëson një individ që të regjistrohet në disa sindikata, që po ashtu është në kundërshtim me Ligjin për organizimin sindikal.

Kjo vegëz, pra, nuk është e lidhur me sistemin e pagave në kuadër të Thesarit. Po të ishte e lidhur me këtë sistem atëherë do të pamundësohej regjistrimi në një sindikatë ata që nuk janë të punësuar e as nuk do të lejohej që një individ të regjistrohej në dy e më shumë sindikata.

Këto dhe shumë lëshime që përcjellin këtë vegëz kanë bërë që SBASHK t'i drejtohet me shkresë drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit për një takim me përfaqësues të SBASHK-ut për t'i debatuar gjithë këto çështje dhe çështje të tjera në mënyrë që deklarimi i anëtarëve sindikalë në këtë vegëz të jetë në përputhje me Ligjin për organizimin sindikal dhe Statutin e sindikatës.

organizohen për të debatuar për situatën aktuale dhe për të marr veprime konkrete në përballje me sfidat e shumta të kohës që janë krijuar nga qasja e gabuar dhe tendencioze e Qeverisë karshi sindikatave.

Kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve vazhdojnë të informojnë për gjendjen aktuale në komunat e tyre dhe në Universitete dhe pastaj edhe marrin qëndrime të përbashkëta për angazhimet dhe aktivitetet në vijim.

Tema të debatit në këto takime janë edhe veprimi arbitrar i Ministrisë së Financave lidhur me mos ndalimin e kuotës sindikale, që është e përcaktuar me

Ligjin për organizimin sindikal, pastaj vonesa e pagesës së kontributit pensional për të punësuarit në arsim si dhe sfida e krijuar lidhur me platformën eKosova, të cilën Ministria e ka krijuar me nguti e me qëllim që të ketë hezitime e të mos regjistrohen fare në të anëtarët e një sindikate për të krijuar mundësinë pastaj që të thuhet se nuk ka organizim sindikal në një sektor të caktuar.

Duke debatuar për këto sfida pjesëmarrësit kanë thënë se është kjo tendencë e Qeverisë për të dëmtuar organizimin sindikal e madje edhe për të shuar në tërësi, por këtyre sfidave po u përgjigjen me maturi anëtarësia dhe veprimtarët sindikalë dhe po vazhdojnë të regjistrohen në eKosova e po ashtu për ta ruajtur


cilësinë e anëtarit sipas kërkesave të Ligjit për organizimin sindikal në Kosovë në shoqata kanë filluar të përgatitin lista duke mbledhur kuotën sindikale e duke e deponuar atë në xhirollogaritë e shoqatave gjegjëse sindikale.

Nga ana tjetër SBASHK-u këto çështje i ka ngritur edhe në komunikim me ETUCE dhe duke kërkuar sqarime nga institucionet dhe veprime konkrete nga organet gjegjëse.

Pjesëmarrësit në këto takime janë të bindur se SBASHK-u, ashtu si në të kaluarën, edhe tani e gjithmonë do të tejkalojë sfidat e kohës dhe do të vazhdojë të ruaj unitetin dhe zërin e fuqishëm sindikal.

Vendimi i njëanshëm i Ministres Nagavci

Kur vendoset me inat, puna nuk ka rrjedhë të mbarë



një vendim për ta ndryshuar shpejt e shpejt Kalendarin e këtij viti shkollor.



Ajo e shpërndau këtë vendim të një anshëm dhe e shtuna e 15 tetorit ia dëshmoi se ka gabuar duke nxjerr këtë vendim pa konsultime paraprake me palët. Në shumicën e shkollave të Kosovës nuk u punua fare të shtunën e 15 tetorit e në pak sosh kishte numër tepër të vogël të nxënësve dhe prandaj u vlerësua se nuk u zhvillua fare procesi mësimor edhe përkundër presioneve e vizitave të inspektorëve të arsimit. Ministria Nagavci edhe duke e parë këtë

Në vend që t'i lente inatet me një anë e të ftonte në takim SBASHK-un, Këshillin e Prindërve, Kolegjiunin e Drejtorëve dhe përfaqësues të Asociacionit të Komunave, Ministria Nagavci e mbushur plot inat për shkak të grevës, nxori me nguti


realitet nuk bëri as edhe një hap për ta ndryshuar gjendjen. Ajo nuk gjeti kohë as vullnet as për ta analizuar propozimin e Asociacionit të Komunave e as nuk qau kokën fare për të dëgjuar kritikën dhe qëndrimin kategorik të Këshillit të Prindërve se të shtunave ata nuk i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë.

Ministrja Nagavci mbase mbante shpresë se e shtuna e 22 tetorit do të ndryshonte gjërat, por prapë e njëjta situatë. Thuaje si të duash procesi mësimor nuk u mbajt. MASHTI vazhdon të këmbëngul në vendimin

e njëanshëm dhe nuk e sheh të udhës të ftojë në një takim pune përfaqësuesit e prindërve dhe të tjerët për të parë se a mund të arrihet ndonjë marrëveshje e përbashkët lidhur me këtë çështje. Ajo, nëse nuk do t'i shoh e t'i dëgjojë të tjerët, se paku duhet të takohet me përfaqësuesit e Këshillit të prindërve të Kosovës sepse kot, edhe nëse gjithë mësimdhënësit dalin në shkollë të shtunave, nëse nuk shkojnë nxënësit nuk mund të mbahet procesi mësimor. Këtë ishte dashur ta kuptoj edhe Ministria Nagavci sepse kur vendoset me inat, puna nuk mund të ketë rrjedhë të mbarë.

Detyrë konkrete nga takimi konsultativ me kryetarët

Vizita nëpër shoqata sindikale për bashkëbisedë me anëtarësinë



Në takimin nga larg të 26 tetorit me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve është bashkëbiseduar për situatën aktuale dhe për sfidat me të cilat janë duke u përballur veprimtarët sindikal në terren. Ishte mendim i përbashkët se ka krijuar ca probleme regjistrimi në eKosova. U tha se ky proces po vazhdon, por ka edhe probleme ngase një numër i anëtarëve nuk e kanë të lehtë të regjistrohen për arsye se kanë më pak njohuri për qasjen në vegëzën e caktuar.


Duke u gjendur në këtë realitet pas një debati përmbajtjesor u mor vendim i përbashkët që kryetarët, por edhe anëtarët e kryesive të nivelit komunal sindikal të vizitojnë shkollat dhe institucionet tjera

arsimore në komunat e tyre dhe të bashkëbisedojnë me anëtarësinë për të ndihmuar ata që të bëjnë regjistrim të suksesshëm në eKosova e po ashtu për të dëgjuar nga afër idetë dhe propozimet konkrete për aktivitetet sindikale.

Ideja e qëlluar për vizita nëpër shkollë e institucione të tjera arsimore u vlerësua si e qëlluar dhe besohet se do t'i paraprijë takimeve të punës së Kuvendeve Sindikale nëpër komuna me pjesëmarrjen e anëtarëve të kryesisë qendrore. Do të jetë kjo mundësi e mirë që kryetarët e shoqatave sindikale të bashkëbisedojnë lirshëm me përfaqësues të nivelit qendror dhe të shohin se si më lehtë e bashkërisht do të përballën me sfidat e shumta të kohës.

ETUCE vazhdon me mbështetjen dhe ndan shqetësimet me SBASHK-un

Bashkërisht në mbrojtje të lirive sindikale



Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës vazhdon komunikimin me përfaqësuesit e SBASHK-ut me qëllim që të ketë sa më shumë informacione dhe të bëjë angazhimet e duhura në mbështetje të organizimit sindikal në Kosovë, i cili është vështirësuar me veprimet e ngutshme e të një anshme të Qeverisë e që për qëllim kishin vështirësimin e aktivitetit sindikal të SBASHK-ut.

Kujtojmë se Drejtoresha e përgjithshme e EUCE, Suzan Flocken kishte ardhur në Kosovë gjatë grevës në përpjekje për të ndihmuar dialogun me Qeverinë dhe arritjen e një marrëveshjeje të pranueshme. Ajo bashkë me stafin qendror në Bruksel kishin vazhduar angazhimin dhe komunikimin duke dëshmuar mbështetjen e fuqishme për SBASHK-un. Pasi kanë marrë informacione ditore për sjelljen me tendencë të Qeverisë ndaj SBASHK-ut, Drejtoresha e përgjithshme Flocken ka mbajtur një takim nga larg me udhëheqës të SBASHK-ut për të marrë informacione shtesë lidhur me situatën aktuale.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala e koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri pasi kanë falënderuar zonjën Suzan për gjithë këto angazhime e kanë informuar atë për situatën aktuale duke treguar se Qeveria vazhdon t'i ikë dialogut dhe nuk po bën as edhe një hap në realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë. Ata kanë shtuar se në vend të kësaj, Ministrja e arsimit, por edhe Ministri i Financave kanë vazhduar të krijojnë me qëllim pengesa për të vështirësuar apo edhe shuar veprimtarinë sindikale të SBASHK-ut dhe sindikatave të tjera duke vepruar në kundërshtim me Ligjin e organizimit sindikal e duke kërkuar që e tërë anëtarësia të regjistrohet individualisht në një platformë të përgatitur me nguti e që nuk i mundëson sindikatës të ketë qasje në të, por mundëson që kushdo të regjistrohet në një sindikatë të caktuar.

Drejtoresha e përgjithshme e ETUCE ka shprehur shqetësim lidhur me këtë gjendje dhe ka shtuar se do të angazhohet bashkë me stafin qendror në Bruksel për të komunikuar me Qeverinë me qëllim të tejkalimit të kësaj situate e po ashtu çështjen do ta ngrit edhe në Komisionin gjegjës të BE-së dhe në Organizatën Ndërkombëtare të Punës.

